

Të kuptoni certifikatën e sigurimeve të pensionit (certificato di previdenza)

Kjo fletë udhëzuese ju paraqet, sesi është ndërtuar një certifikatë e sigurimeve të pensionit. Ajo jep sqarime dhe përmban informacione të dobishme për tema të rëndësishme.

Paragrafët me numra u referohen secili seksioneve në modelin e certifikatës së sigurimeve të pensionit. Ju lutemi vini re, që modeli i certifikatës së sigurimeve të pensionit mbulon të gjitha zgjidhjet për pension të fondacioneve kolektive, të drejtuara nga Swiss Life. Nëse keni pyetje konkrete për zgjidhjen tuaj për pension, përcaktimet i gjeni në rregulloren e sigurimeve të pensionit.

1 Të dhëna të përgjithshme (Indicazioni generali)

Këtu tregohen të dhënat mbi kontratën dhe personin tuaj. *Paga vjetore e deklaruar (salario annuo notificato)* si rregull përkon me pagën vjetore AHV të deklaruar nga punëdhënësi juaj dhe duhet të përputhet me pagën tuaj vjetore efektive (paga bruto sipas vërtetimit të pagës).

Paga vjetore duke hequr zbritjen e koordinimit jep pagën e siguruar. Zbritja e koordinimit shërben për koordinimin me kolonën e parë (Sigurimet e detyrueshme federale për pension pleqërie dhe për pension për persona të lënë pas AHV).

2 Depozita e pleqërisë (Avere di vecchiaia)

Depozita juaj *ekzistuese e pleqërisë (avere di vecchiaia disponibile)* llogaritet me ditë të sakta dhe është e vlefshme për datën e lëshimit. Ajo përmban kontributet vjetore të kursimit, shumat e kalimit të lirë të transferuara, interesat si edhe blerjet dhe kontribute të çfarëdo lloji tjetër (p.sh. tepricat).

Nëse ndërpritni marrëdhëniet tuaja të punës, ju gëzoni *të drejtën e kalimit të lirë (diritto al libero passaggio)*. Shuma i përcillet institutit të sigurimeve të punëdhënësit tuaj të ri. Mundësitë për rastin që nuk filloni një punë të re, i gjeni në fletën udhëzuese «Austritt» (Dalja) nën linkun të certifikata juaj e sigurimeve të pensionit (shikoni Nr. 11).

Për pagesën e interesit për paratë tuaja të sigurimeve të pensionit vlejnjë normat e interesit të dhëna të certifikata juaj. Normat e interesit për pjesën e detyrueshme përcaktohen çdo vit nga Kuvendi Federal, pagesa e interesit për shumën e depozituar mbi pjesën e detyrueshme përcaktohet - sipas zgjidhjes për pension - nga këshilli i fondacionit ose nga komisioni administrativ.

3 Përfitimet në moshën e pensionit (Prestazioni di vecchiaia)

Kur dilni në pension, si rregull keni mundësi zgjedhjeje midis pensionit të pleqërisë që zgjat gjithë jetën, derdhjes njëherësh të të gjithë kapitalit të grumbulluar ose një kombinimi të të dyjave.

Ju shikoni *kapitalin (capitale)* e parashikuar ose *pensionin (rendita)* e parashikuar në momentin e daljes së rregullt në pension ose në momentin e daljes së parakohshme në pension. Kapitali i parashikuar llogaritet me përafërsi me të dhënat që njihen sot (depozita ekzistuese e pleqërisë, paga e siguruar, kontributet vjetore për pension pleqërie dhe kohëzgjatja e sigurimit deri në dalje në pension). Interesi i projektimit i përdorur për llogaritjen e përafërt orientohet sipas normës efektive të interesit të shumëzës së depozituar për pension pleqërie në vitet e fundit dhe po ashtu është i shënuar në certifikatë. Kapitali përbën bazën për llogaritjen e pensionit të pleqërisë.

Norma e konvertimit është vendimtare për vlerën e pensionit. Pensioni llogaritet nga shumëzimi i kapitalit me normën e konvertimit. Në rastin e lënies së parakohshme të punës, norma e konvertimit zvogëlohet dhe për pasojë edhe pensioni. Pensionin e pleqërisë ju e merrni pas daljes në pension deri në fund të jetës suaj.

Veç pensionit të pleqërisë jepen edhe *pensionet e fëmijëve të personit në pension (rendite per figli di pensionati)*, nëse ky përfitim është parashikuar në planin e sigurimeve për pensionin. Një pension për fëmijë ju e merrni pas daljes suaj në pension për çdo fëmijë të paktën deri në moshën 18 vjeç (në rastin e ndjekjes së shkollës, deri në moshën 25 vjeç). Gjithashtu janë të siguruar edhe përfitimet për personat e lënë pas për bashkëshortët/partnerët bashkëjetues dhe fëmijët.

4 Financimi i daljes së parakohshme në pension (Finanziamento del pensionamento anticipato)

Në rast se vendosni për të dalë para kohe në pension, këtui shikoni maksimumin e mundshëm të *Shumës së blerjes për një pension të parakohshëm (versamento supplementare a titolo d'acquisto massimo)*. Duke derdhur këtë shumë, mund të siguroheni, që edhe në rast të daljes para kohe në pension të merrni pensionin e plotë. Ju lutemi vini re, që këto informacione dalin vetëm pas shfrytëzimit të plotë të pjesës së mbetur të potencialit tuaj të blerjes (shikoni Nr. 7).

5 në rast invaliditeti (Prestazioni d'invalidità)

Ju e merrni të plotë *pensionin vjetor të invaliditetit (rendita d'invalidità annuale)* kur, sipas sigurimit federal të invaliditetit, jeni invalid të paktën në masën 70% dhe afati i pritjes ka skaduar.

Në rastin e invaliditetit të pjesëshëm, shumia e përfitimeve të invaliditetit përcaktohet duke marrë në konsideratë shkallën e invaliditetit sipas rregullores së sigurimeve të pensionit. Përfitimet fillojnë tashme nga shkalla e invaliditetit prej 25%.

Për çdo fëmijë ju merrni të paktën deri në moshën 18 vjeç (në rastin e ndjekjes së shkollës, deri në moshën 25 vjeç) një *pension për fëmijën e personit invalid (rendita per figli d'invalidi)*, nëse ky përfitim është parashikuar në planin e sigurimeve të pensionit.

Çlirim nga detyrimi i pagesës së kontributeve (L'esonero dal pagamento dei contributi) do të thotë, që ju dhe punëdhënësi juaj, në rastin e invaliditetit dhe pas skadimit të afatit të pritjes, nuk duhet të paguani më asnjë kontribut. Përfitimet tuaja të pensionit të pleqërisë, të pensionit për personat e lënë pas dhe të pensionit të invaliditetit vazhdojnë të qëndrojnë në të njëjtën masë.

6 Përfitimet në rast vdekjeje para daljes në pension (Prestazioni in caso di decesso prima del pensionamento)

Në rastin e vdekjes së personit të siguruar, për personin bashkëjetues dhe partnerin homoseksual janë të vlefshme të njëjtat kushte si për çiftet e martuara dhe të regjistruara, nëse jetesa së bashku në një shtëpi ka ekzistuar të paktën për pesë vjetet e fundit përpara vdekjes së personit të siguruar dhe nëse duhet kujdesur për fëmijët e përbashkët. Vendimtare janë përcaktimet e rregullores së sigurimeve të pensionit të vlefshme në momentin e vdekjes. Në vend të *pensionit të bashkëshortit ose të partnerit (rendita per coniugi o per conviventi)*, bashkëshorti juaj ose personi juaj bashkëjetues mund të kërkojë marrjen e plotë ose të pjesëshme të kapitalit.

Çdo fëmijë me të drejtë përfitimi merr të paktën deri në moshën 18 vjeç (në rastin e ndjekjes së shkollës, deri

në moshën 25 vjeç) një pension *për fëmijët jetimë (rendita per orfani)*, nëse ky përfitim është parashikuar në planin e sigurimeve të pensionit.

7 Blerja dhe kthimet (Acquisto e rimborso)

Shumica e personave të siguruar zotërojnë një potencial për blerje në shtyllën e dytë. Me këtë arrini përfitimet më të larta ose ndoshta maksimale nga sigurimet e pensionit. Vini re, që blerjet mund të kryhen, sipas ligjit, vetëm kur janë kthyer tërheqjet e parakohshme për pronësinë e banesës.

Informacione të tjera të dobishme për *Blerjen dhe kthimet (acquisto e rimborso)* dhe kushtet e përgjithshme ligjore i gjeni në fletën udhëzuese «Einkauf» (Blerja) nën linkun te certifikata juaj e sigurimeve të pensionit (shikoni Nr. 11).

8 Financimi (Finanziamento)

Me punëdhënësin tuaj financoni përfitimet e siguruar. Punëdhënësi juaj e zbret kontributin tuaj mujor nga paga juaj bruto. Diferencën me totalin e paguan punëdhënësi juaj.

Kontributi i kursimeve (contributo di risparmio) (pjesa e kontributit për përfitimet e pleqërisë) ndikon direkt mbi depozitën e pleqërisë. Me *Kontributet për rreziqet (contributi di rischio)* do të financohen përfitimet e siguruar në rast invaliditeti dhe vdekjeje.

9 Informacione të përgjithshme (Informazioni generali)

Tërheqja e parakohshme maksimalisht e mundshme për pronësinë e banesës (prelievo anticipato massimo possibile per finanziare la proprietà di un'abitazione) përkon deri në moshën 50 vjeç me të drejtën përkatëse të kalimit të lirë. Pas kësaj moshe, mund të tërhiqet ose gjysma e së drejtës aktuale të kalimit të lirë, ose e drejta e kalimit të lirë për moshën 50 vjeçare, në varësi se cila shumë është më e madhe.

10 Komisioni administrativ (Commissione amministrativa)

Pjesëtarët e komisionit administrativ marrin përsipër në mënyrë të veçantë vënien në zbatim të rregullores së sigurimeve të pensionit, informimin e personave të siguruar dhe zgjedhjen e pjesëtarëve të këshillit të fondacionit.

11 Shënime (Osservazioni)

Informacione të mëtejshme, në mënyrë të veçantë rregulloren e sigurimeve të pensionit dhe kushtet e vlefshme aktuale, i gjeni nën linkun e dhënë. Pyetjet tuaja në lidhje me sigurimet të pensionit mund t'i diskutoni direkt me këshilltarin tuaj për klientin, dhe ai është i gatshëm t'ju këshillojë me kënaqësi.

Campione di certificato di previdenza 2019: recto

Fondazione collettiva LPP Swiss Life
Campione SA, Modello



CH/UXX-PXSX / XXXXXX / 756.XXXX.XXXX.XX

Personale/Confidenziale

Signora
Paola Campione



Certificato di previdenza per la signora Paola Campione

valido a partire dalla data **01.02.2019**

Motivo di allestimento: **Entrata prestazione di libero passaggio**

Parte attiva
Importi in CHF

① Indicazioni generali	Contratto XXXXXX	Salario annuo notificato	45'480.00
	Gruppo di persone assicurate 001	Salario conteggiabile parte di risparmio	33'142.50
	Portafoglio normale	Salario conteggiabile parte di rischio	45'480.00
	N. d'assicurata/o 756 XXXX.XXXX.XX		
	Data di nascita 28.03.1961		
	Grado di occupazione 50.00%		
		Parte obbligatoria	Totale
② Avere di vecchiaia	Avere di vecchiaia disponibile in data 01.01.2019	13'352.10	76'057.65
	Accredito degli interessi per il periodo 01.01.2019 - 01.02.2019	13.90	53.15
	Versamento (Libero passaggio) 01.02.2019	0.00	75'900.65
	Accredito di vecchiaia per il periodo 01.01.2019 - 01.02.2019	312.10	497.15
	Avere di vecchiaia in data 01.02.2019	13'678.10	152'508.60
	Diritto alla prestazione di libero passaggio in data 01.02.2019	13'678.10	152'508.60
	Tasso d'interesse valido per il periodo menzionato		
• per la parte obbligatoria	x.xxx%		
• per la parte sovraobbligatoria	x.xxx%		
		Capitale oppure	Rendita
③ Prestazioni di vecchiaia	All'età di 64 anni 01.04.2025	206'774.75	11'201.25
	All'età di 63 anni 01.04.2024	197'355.40	10'363.90
	All'età di 62 anni 01.04.2023	188'098.00	9'589.80
	All'età di 61 anni 01.04.2022	178'999.90	9'102.60
	All'età di 60 anni 01.04.2021	170'058.25	8'658.80
	All'età di 59 anni 01.04.2020	161'270.35	8'253.10
	All'età di 58 anni 01.04.2019	153'704.90	7'911.60
Ulteriori prestazioni di vecchiaia (in percento della prestazione di vecchiaia percepita sotto forma di rendita)			
• Rendita per figli di pensionati 20%			
• Rendita per coniugi/conviventi in caso di decesso dopo il pensionamento 60%			
• Rendita per orfani in caso di decesso dopo il pensionamento 20%			
Tasso d'interesse ipotetico per il calcolo delle prestazioni di vecchiaia: x.xxx%			
Trova i tassi rilevanti per la conversione dell'aver di vecchiaia in una rendita, come pure i tassi d'interesse attuali al sito www.swisslife.ch/it/protect/			
④ Finanziamento pensionamento anticipato	Versamento supplementare a titolo d'acquisito per il pensionamento anticipato		Massimo
	l'età di 63 anni in data 01.02.2024		15'357.55
	l'età di 62 anni in data 01.02.2023		30'737.60
	l'età di 61 anni in data 01.02.2022		40'323.65
	l'età di 60 anni in data 01.02.2021		49'105.70
	l'età di 59 anni in data 01.02.2020		57'128.00
l'età di 58 anni in data 01.04.2019		64'056.70	
Per quanto riguarda il finanziamento rinviamo al regolamento di previdenza.			

Campione di certificato di previdenza 2019: verso

Contratto XXXXXX N. d'assicurata/o 756.XXXX.XXXX.XX
Signora Paola Campione, Data di nascita 28.03.1961

		Importi in CHF		
5	Prestazioni d'invalidità	Rendita d'invalidità annuale (periodo d'attesa: 24 mesi)	Infortunio	Malattia
			0.00	15'918.00
		Rendita per figli d'invalidi annuale (periodo d'attesa: 24 mesi)	0.00	502.20
		Esonero dal pagamento dei contributi (periodo d'attesa: 3 mesi)		
		Le prestazioni indicate corrispondono a un grado d'invalidità del 100%.		
		Le prestazioni d'invalidità sono pagabili al massimo fino in data 31.03.2025.		
6	Prestazioni in caso di decesso prima del pensionamento	Rendita per coniugi / conviventi annuale	Infortunio	Malattia
			0.00	1'506.55
		Rendita per orfani annuale	0.00	502.20
		Capitale di decesso in aggiunta alla rendita per coniugi / conviventi	152'508.60	119'333.25
	Capitale di decesso, se non è esigibile alcuna rendita per coniugi/conviventi	152'508.60	152'508.60	
7	Acquisto / Rimborso	Totale del versamento possibile in data 01.02.2019	Parte obbligatoria	Totale
			0.00	0.00
		• Quota rimborso di prelievi anticipati per finanziare la proprietà d'abitazione	0.00	0.00
		• Quota rimborso in seguito a divorzio/scioglimento dell'unione domestica registrata	0.00	0.00
		• Quota acquisto nella cassa pensione		0.00
		I prelievi anticipati per finanziare la proprietà d'abitazione devono essere rimborsati prima di un acquisto.		
8	Finanziamento	Contributo di risparmio	Dipendente	Totale
			2'971.20	5'942.40
		Contributi di rischio, costi e contributi supplementari prescritti legalmente	622.80	1'245.60
		Contributo annuo	3'594.00	7'188.00
	Contributo mensile 1/12	299.50	599.00	
9	Informazioni generali	Prestazione di libero passaggio all'età di 50 anni	Parte obbligatoria	Totale
		Importo disponibile per finanziare la proprietà d'abitazione in data 01.02.2019		50'723.55
		Costituzione in pegno per finanziare la proprietà d'abitazione: no		50'723.55
10	Commissione amministrativa	Presidente: Marco Ponte, Modello		
		Rappresentanti dei dipendenti	Rappresentanti del datore di lavoro	
		Paolo Campione, Modello	Marco Ponte, Modello	
11	Osservazioni	Trova ulteriori informazioni al sito: www.swisslife.ch/it/protect/		
		I valori riportati sono basati su ipotesi attualmente valide e hanno carattere meramente informativo.		
		In merito alla scadenza e al diritto delle prestazioni, rimandiamo al regolamento di previdenza e al piano di previdenza che fungono da base del presente certificato di previdenza.		
		In caso di domande voglia rivolgersi a Signo/Signora Primo Nome, Cognome, tel 043 284 XX XX.		
La sua previdenza on line	Il portale on line le fornisce una panoramica dei suoi dati sulla previdenza. Inoltre può pianificare on line il suo futuro finanziario.			
	Si registri, oggi stesso, al sito myworld.swisslife.ch per beneficiare dei nostri servizi.			
Allestito da Swiss Life in data 15.01.2019 su incarico della vostra istituzione di previdenza.				